



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 55 date 27/04/2001

**PER  
MIRATIMIN E NDERLIDHESAVE ME KOMUNITETIN NE NJESITE  
BASHKIAKE TE TIRANES**

Këshilli Bashkiak të Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.27.04.2001, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit “Për miratimin e Ndërlidhësave me Komunitetin në Njësitë Bashkiake të Tiranës”, mbështetur në ligjin nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligjit nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”

**V E N D O S I**

1. Të miratojë caktimin e 190 Ndërlidhësave me Komunitetin për Njësitë Bashkiake të Tiranës. Për detajimin e numrit të Ndërlidhësave me Komunitetin për çdo njësi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit
2. Të miratojë shpërblimin e Ndërlidhësave me Komunitetin prej 3000 lekësh për çdo ndërlidhës me fondin limit prej 6.840.000 lekësh për vitin 2001 nga fondi i të ardhurave të Aparatit të Bashkisë (Art.602)
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Njësitë Bashkiake
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**

